



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija za imovinske zahteve Kosova

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR:1

NR I VENDIMIT.: KPCC/D/A/113/2011
DATA E VENDIMIT: 22/06/2011

Komisionerë Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

- (1) Në secilën nga tridhjetë e tetë (38) kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.
- (2) Në secilën nga njëmbëdhjetë (11) kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet.
- (3) Në kërkesat me nr. 51793, 51794 dhe 51798, të përmendura në pjesën C të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që bartësi i së drejtës pronësore ka vërtetuar të drejtën pronësore për pronat e kërkuara ashtu si përcaktohet në vendimet individuale respektive.
- (4) Në kërkesën nr. 51793, 51794 dhe 51798, Komisioni urdhëron që
 - a) Paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;
 - b) Çdo person, i cili e ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe
 - c) Nëse cilido person i cili e ka uzurpuar pronën dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke miratuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili miraton dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e tretë nga 20 deri 22 qershor 2011 në Prishtinë. Gjithsej i janë paraqitur Komisionit 2,548 kërkesa bujqësore në seancën e njëzetë e tretë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante. Pesë kërkesa bujqësore që i ishin paraqitur Komisionit iu kthyen Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për verifikim të mëtejshëm dhe tre kërkesa u tërhoqën nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e një kërkesë në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Gjithsej, 2,539 kërkesa për pronë bujqësore u shqyrtuan nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim.

7. Në kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim përfshin gjithsej 52 kërkesa, ashtu si janë përcaktuar në listën e bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 2,496 kërkesash për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës, përfshihen në dy vendimet e tjera, pikërisht vendimet KPCC/D/A/112/2011 dhe KPCC/D/A/114/2011.

9. Gjithsej 51 nga 52 kërkesa të përfshira në këtë vendim nuk janë shqyrtuar më parë nga Komisioni, ndërsa një kërkesë (kërkesa nr. 41160) kanë qenë subjekt i një vendimi të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm në këtë kërkesë është shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronës së kërkuar gjatë përpunimit të kërkesës nga Sekretaria Ekzekutive. Për rrjedhojë, kjo kërkesë duhet të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar. Nuk është paraqitur asnjë palë përgjegjëse e kërkesës ose uzurpues i pronës për këtë kërkesë. Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësi i kërkesës si dhe autoritetet kadastrave përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Anekset e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Anekset e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Anekset I, II dhe III, respektivisht.

11. 38 kërkesat e listuara në pjesën A të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose një pale që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, secilës prej palëve përgjegjëse i është dorëzuar një kopje e kërkesës të parashtruar nga paraqitësi përkatës i kërkesës. Në bazë të nenit 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësve të kërkesave u është dorëzuar një kopje e dokumenteve të parashtruara nga palët respektive përgjegjëse në kërkesë. Të dy palëve, në secilën rast, u është dhënë mundësia të komentojnë për informacionin e ofruar nga pala tjetër, edhe komentet apo informacioni i tillë është marrë në konsideratë gjatë përpunimit dhe vendosjes të kërkesës. Komisioni vëren se pala përgjegjëse e përfshirë në pjesët D dhe E të listës së bashkangjitur këtij vendimi refuzoi të pranojë një kopje të dokumenteve të ofruara nga paraqitësit e parë edhe të dytë në këto kërkesa.

12. 11 kërkesat e shënuara në pjesën B të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionet e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

B. Kërkesa të hedhura poshtë.

13. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

14. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

15. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykate vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit).

16. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj për pronën e kërkuar.

17. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

1. Kërkesat nr. 38043, 38044, 38045, 38046 dhe 38047

18. Kërkesat nr. 38043, 38044, 38045, 38046 dhe 38047, të përmendura në pjesën A të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i bartësit të së drejtës pronësore.

19. Pala përgjegjëse, e cila aktualisht uzurpon pronat e kërkuara, pretendon se i ka blerë pronat nga paraqitësi i kërkesës në tetor të vitit 2000 dhe ka parashtruar kontratën e blerjes në mbështetje të pretendimeve të tij. Paraqitësi i kërkesës e konfirmon shitjen e pronës së kërkuar. Megjithatë, ai thotë se pala përgjegjëse ka dështuar të paguajë dy këstet e fundit të çmimit të pajtuar të blerjes dhe pas marrëveshjes gjyqësore për pagesën e çmimit të blerjes në vitin 2005 nga Gjykata Komunale e Rahovecit, paraqitësi i kërkesës edhe pala përgjegjëse nuk kanë dakord për shumën e mbetur të interesit që duhej të paguhej nga pala përgjegjëse për paraqitësin e kërkesës.

20. Bazuar në deklaratat jokontestuese të paraqitësit të kërkesës edhe palës përgjegjëse në lidhje me marrëveshjen e ndërsjellë të blerjes, Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar si rezultat i drejtpërdrejtë i konfliktit të armatosur në Kosovë gjatë 1998-1999, por përmes shitjes që u bë në vitin 2000. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të hidhet poshtë në pajtim me nenin 11.4(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

2. *Kërkesat nr. 44015, 44021, 44026 dhe 44031.*

21. Kërkesat me nr. 44105, 44021, 44026 dhe 44031, të përmendura në pjesën A të listës së bashkangjitur, janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj.

22. Sekretaria Ekzekutive i ka notifikuar fizikisht pronat e kërkuara. Gjatë procesit të notifikimit, Z. Rexhep Gijkolli ("Pala përgjegjëse"), i cili është përfaqësuesi i autorizuar i shfrytëzuesit aktual të pronave të kërkuara, e kundërshtoi titullin pronësor të paraqitësit të kërkesës dhe pretendoi për të drejta ligjore të klientëve të tij në lidhje me pronat respektive. Ai pohon se bartësi i së drejtës pronësore ia ka shitur pronat familjeve të klientëve të tij, Gazmend Lleshdedaj (Kërkesat nr. 44015 dhe 44026), Tome Krhani (Kërkesa nr. 44031) dhe Dake Radi (Kërkesa nr. 44021) në vitin 1968, 1969 dhe 1970, respektivisht. Në mbështetje të pohimeve të tij, pala përgjegjëse parashtroi kontratat e shitjes për transferimet e pretenduara, të gjitha të pavërtetuara edhe deklaratat e dëshmitarëve.

23. Fillimisht, paraqitësja e kërkesës pretendoi se familja e saj i humbi pronat për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999, megjithatë, më vonë paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se familja e saj nuk e ka pasur posedimin e pronës që nga viti 1970 e më pas. Ajo konfirmoi gjithashtu se ajo as nuk i kishte në posedim dhe as nuk i shfrytëzonte pronat e kërkuara në kohën e konfliktit të vitit 1998-99 në Kosovë. Në këto rrethana, Komisioni arrin në përfundimin se humbja e pretenduar e të drejtave pronësore nuk mund të thuhet se ndërlidhet me konfliktin. Rrjedhimisht, kërkesa e paraqitësit të kërkesës bie jashtë juridiksionit të Komisionit edhe duhet të hidhet poshtë.

3. *Kërkesa nr. 00437.*

24. Në kërkesën nr. 00437, paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pohon se ka një kontest për kufijtë e saktë pronësorë ndërmjet pronës që ai bleu në vitin 1988 edhe pronës fqinje në pronësi të palës përgjegjëse.

25. Sekretaria Ekzekutive kontaktoi paraqitësin e kërkesës për të sqaruar nëse kërkesa e paraqitësit të kërkesës ndërlidhet në një fare mënyre me rrethanat e konfliktit ashtu si ishte pretenduar fillimisht se posedimi i pronës humbi në vitin 1999. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se nuk ka pasur humbje të posedimit për shkak të konfliktit të vitit 1998-99 dhe se kërkesa ka të bëjë me një kontest pronësor për kufijtë e pronës në lidhje me pronën fqinje. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

4. *Kërkesat nr. 08235, 08239, 30841, 30842, 30843, 30844, 30845, 30846, 30847, 30848, 30849 dhe 30850.*

26. Kërkesat nr. 08235 dhe 08239, të përmendura në pjesën A të listës së bashkangjitur, janë depozituar nga Slavko Kalajdjic ("Paraqitësi i pare i kërkesës") në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore në pjesën ideale prej 1/3 të pronave respektive. Kërkesa nr. 30841, 30842, 30843, 30844, 30845, 30846, 30847, 30848, 30849 dhe 30850 janë parashtuar nga mbesa ("Paraqitësi i dytë i kërkesës") e paraqitësit të parë të kërkesës si person i autorizuar i bartësit të së drejtës pronësore. Kërkesat nr. 08235 dhe 30841 ndërlidhen me të njëjtën pronë ashtu si ndërlidhen edhe kërkesat me nr. 08239 dhe 30845, respektivisht. Në kërkesat me nr. 08235 dhe 08239 paraqitësi i pare i kërkesës kërkon pjesën ideale prej 1/3, dhe në kërkesat me nr. 30842 dhe 30845 paraqitësi i dytë i kërkesës kërkon pjesën ideale prej 1/6 të pronës së kërkuar.

27. Të gjithë pronat e kërkuara nga paraqitësi i parë edhe i dytë i kërkesës janë notifikuar fizikisht nga Sekretaria Ekzekutive. Gjatë procesit të notifikimit, gjashtë individë, Sabit dhe Islam Tusha, Xhelal Kosumi, Hajriz Azizi, Hasim Salihu dhe Gege Zefi të cilët janë aktualisht duke shfrytëzuar pronat e kërkuara, me përjashtim të kërkesës nr. 30848, iu përgjigjen notifikimit edhe kërkuar të drejta ligjore për pronat respektive.

28. Në kërkesën nr. 30848 prona e kërkuar është aktualisht e uzurpuar nga KFOR-i, i cili në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 gëzon imunitet nga procedimi ligjor.

29. Të dy, paraqitësi i parë dhe i dytë i kërkesës, pranojnë se bartësit e të drejtave pronësore edhe familjet e tyre nuk e kanë pasur posedimin e pronave të kërkuara që nga viti 1961 e më pas kur pronat u shitën edhe posedimi iu transferua Ajdin Tushës. Pas vdekjes së bartësit të së drejtës pronësore Petrusha Kalajdjic, është nxjerrë një vendim trashëgimie i vitit 1992 në lidhje me pronat, i cili e shpërfill shitjen e mëparshme në vitin 1961. Të dy paraqitësit e kërkesave konfirmuan se ata nuk kanë pasur as posedimin edhe as shfrytëzimin e pronave në kohën e konfliktit në Kosovë më 1998-99. Në këto rrethana, Komisioni arrin në përfundimin se humbja e pretenduar e të drejtave pronësore nuk mund të thuhet së ndërlidhet me konfliktin. Rrjedhimisht, kërkesa e paraqitësve të kërkesave bie jashtë juridiksionit të Komisionit edhe duhet të hidhet poshtë.

5. *Kërkesa të hedhura poshtë për mungesë të autorizimit.*

30. Në kërkesat nr. 36541, 36542, 36543 dhe 36544, personi që ka depozituar kërkesat është dhëndëri i bartësit të së drejtës pronësore.

31. Në kërkesat nr. 13629 dhe 13634 personi që ka depozituar kërkesat është e reja e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore.

32. Kërkesat nr. 01449, 01450 dhe 01453 janë depozituar nga nipi i bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore.

33. Në bazë të nenit 5.2 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079, kërkesat mund të paraqiten nga bartësi i së drejtës pronësore, anëtar i bashkësisë familjare ose nga personi fizik i autorizuar i cili posedon autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit nga bartësi i së drejtës pronësore apo anëtar i bashkësisë familjare i atij personi. Në raste të jashtëzakonshme kur paraqiten probleme për sigurimin e autorizimit, Sekretaria mund të vërtetojë një dokument alternativ i cili autorizon përfaqësuesin e paraqitësit të kërkesës.

34. Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë banuar apo jo në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky përkufizim përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipat/mbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, ky përkufizim nuk përfshin të afërmit nga lidhja martesore, dajallarët/ xhaxhallarët, tezë/hallat, nipat, mbesat apo kushërinjtë ose kushërinj të tjerë më të largët, të cilët duhet të paraqesin autorizimin për përfaqësimin e tyre në emër të bartësit të së drejtës pronësore ose anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të

së drejtës pronësore. Individët të cilët nuk bien në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare nuk mund të konsiderohen si paraqitës të kërkesave por si persona që synojnë të përfaqësojnë paraqitësin e kërkesës.

35. Kërkesat në të cilat personi që depoziton kërkesën nuk është anëtar i bashkësisë familjare, nuk mund të konsiderohen kërkesa të plota në përputhje me nenin 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin. 03/L-079, pasi nuk është përmbushur kërkesa themelore procedurale, pikërisht autorizimi nga bartësi i së drejtës pronësore ose anëtari i bashkësisë familjare i bartësit të së drejtës pronësore.

36. Pasi paraqitësit e kërkesave në kërkesat nr. 36541, 36542, 36543, 36544, 13629, 13634, 01449, 01450 dhe 01453 nuk ofruan autorizim nga anëtari i bashkësisë familjare, Sekretaria Ekzekutive i kontaktoi paraqitësit e kërkesave disa here duke u kërkuar atyre të dorëzojnë autorizimin e munguar. Megjithatë, paraqitësit e kërkesave kanë dështuar të ofrojnë autorizim. Në kërkesat nr. 01449, 01450 dhe 01453 paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai nuk do të ofronte autorizim por as nuk do ta tërhiqte kërkesën edhe nuk ishte i interesuar që ta ndiqte kërkesën. Në këto rrethana, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë për shkak të dështimit të paraqitësit të kërkesës për të ofruar autorizim për cilësinë e depozitimit të kërkesës në emër të bartësit të së drejtës pronësore.

37. Komisioni vëren se vendimi për të hedhur poshtë kërkesën nuk cenon vlerësimin ligjor për të drejtat e mundshme të shfrytëzimit të uzurpuesve aktualë të pronave të kërkuara.

6. *Kërkesat nr. 11649 dhe 11653.*

38. Në kërkesat nr. 11649 dhe 11653 paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij Serif Kurtishaj. Paraqitësi i kërkesës pretendon se pronat e kërkuara i takonin gjyshit të tij deri në vitin 1938, kur e drejta pronësore iu dha familjes Nikolic me vendim të Gjykatës Supreme të Shkupit. Paraqitësi i kërkesës pohon gjithashtu se gjatë vitit 1990, familja Nikolic e detyroi familjen e paraqitësit të kërkesës ta blinte përsëri pronën, megjithatë, paraqitësi i kërkesës dështoi të ofrojë ndonjë provë në mbështetje të transaksionit të pretenduar. Është e dukshme se humbja e pretenduar e posedimit nuk ndërlidhet me konfliktin e vitit 1998-99; në të vërtetë vetë paraqitësi i kërkesës deklaroi se gjyshi i tij e humbi posedimin në vitin 1938. Rrjedhimisht, kërkesa e paraqitësit të kërkesës, bie jashtë juridiksionit të Komisionit edhe duhet të hidhet poshtë.

7. *Kërkesa nr. 00732.*

39. Në kërkesën nr. 00732 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Gjatë bisedës telefonike me Sekretarinë Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai kishte nënshkruar kontratën e shitjes me palën përgjegjëse dhe uzurpuesin aktual Azem Gashi. Paraqitësi i kërkesës pohoi se pala përgjegjëse nuk e kishte paguar çmimin tërësor të blerjes dhe tregoi se do të parashtronte një deklaratë me shkrim me hollësitë e mëtejme. Pala përgjegjëse i mohon pohimet e paraqitësit të kërkesës dhe pohon se çmimi i blerjes është paguar tërësisht. Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar si të vlefshme kontratën e vërtetuar të blerjes, midis palëve të datës 7 shtator 2007 të paraqitur nga pala përgjegjëse.

40. Më pas, Sekretaria Ekzekutive u përpoq të kontaktonte paraqitësin e kërkesës disa herë përmes të dhënave të ofruara nga paraqitësi i kërkesës, megjithatë nuk u vendos asnjë lloj kontakti. Në këto rrethana, e duke pasur parasysh që paraqitësi i kërkesës nuk e mohoi se ka pasur një transaksion vullnetar, nuk mund të thuhet se ka pasur humbje të posedimit për shkak

të konfliktit të vitit 1998-99. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit e duhet të hidhet poshtë.

C. Kërkesa të refuzuara.

41. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk kanë mundur të dëshmojnë interesin për të drejtën pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

42. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin nr 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat e së drejtës pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo prova të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e paraqitura nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të dhënave publike. (Neni 6.2 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6.3 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të drejtohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmive të aplikuara në gjykatat vendore në Kosovë (pika 6.1 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079).

1. Kërkesat nr. 24201, 24204, 24214, 24216, 24220, 24222, 24225, 24227, 24228 dhe 24229.

43. Në kërkesat nr. 24201, 24204, 24214, 24216, 24220, 24222, 24225, 24227, 24228 dhe 24229 paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht gjyshit të tij të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës deklaron se është i vetmi trashëgimtar i gjallë i nënës së tij të ndjerë. Ai deklaron se nuk është iniciuar procedura e trashëgimisë pas vdekjes së gjyshit të tij, megjithatë, nëna e tij i ka shitur disa prona një pale të tretë në vitin 1974. Paraqitësi i kërkesës deklaron se ai nuk di se cilat prona janë shitur e cila nuk janë shitur. Ai fillimisht pohoi se sipas dijenisë të tij, çmimi i blerjes ishte paguar vetëm pjesërisht nga blerësi në atë kohë, megjithatë kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive ai pranoi përsëri se ishte paguar çmimi i plotë i blerjes.

44. Sekretaria Ekzekutive ka bërë notifikimin fizik të pronave të kërkuara. Gjatë procesit të notifikimit, uzurpuesi aktual ("pala përgjegjëse") iu përgjigj notifikimit të kërkesës. Pala përgjegjëse pretendon se xhaxhai/daja i tij i bleu pronat nga nena e paraqitësit të kërkesës në vitin 1974 dhe se familja e tij ka shfrytëzuar e pa shqetësuar pronën që nga ajo kohë.

45. Paraqitësi i kërkesës nuk ka përcaktuar se cilat prona po kërkon edhe ka dështuar të ofrojë ndonjë provë që të dëshmojë pronësinë e ndonjërit nga pronat e kërkuara. Rrjedhimisht, kërkesat duhet të refuzohen për mungesë të provave.

2. Kërkesa nr. 23497.

46. Në kërkesën nr. 23497 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesën në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore dhe parashtoi fletën poseduese e cila është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

47. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar fizikisht pronën e kërkuar. Gjatë procesit të notifikimit të pronës, uzurpuesi aktual iu përgjigj kërkesës duke pretenduar se ai e kishte blerë pronën nga paraqitësi i kërkesës në vitin 1996. Në mbështetje të pohimit të tij, ai parashtroi një kontratë blerje të pavërtetuar të datës 5 qershor 1996. Pala përgjegjëse shpjegon se nuk ka pasur mundësi të vërtetojë kontratën në atë kohë dhe nuk ka iniciuar procedurën e duhur gjyqësore pas konfliktit të vitit 1999 për shkak të mungesës së fondeve për të mbuluar shpenzimet që ndërlidhen me atë.

48. Sekretaria Ekzekutive u përpoq të kontaktojë paraqitësin e kërkesës për të ballafaquar atë me pretendimet e palës përgjegjëse, por nuk mundi të hyjë në kontakt me paraqitësin e kërkesës. Më 19 shkurt 2011, Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi të birin e paraqitësit të kërkesës, Zoran Vasic, i cili konfirmoi se babai e kishte shitur pronën. Më 27 mars 2011, Sekretaria Ekzekutive arriti të kontaktojë paraqitësin e kërkesës, por ai refuzoi çdo bashkëpunim edhe se nuk dëshironte të kontaktohej nga Sekretaria Ekzekutive.

49. Ashtu si u vërejt më sipër, Sekretaria Ekzekutive, ka verifikuar fletën poseduese që ka parashtruar paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës së tij. Megjithatë, pala përgjegjëse ka dorëzuar një kontratë blerje e cila tregon se ai e ka blerë pronën, edhe pse kontrata është e pavërtetuar, pala përgjegjëse ka ofruar një shpjegim të besueshëm e logjik se pse kontrata e blerjes midis paraqitësit të kërkesës dhe palës përgjegjëse nuk është formalizuar kurrë. Paraqitësi i kërkesës dështoi t'i përgjigjej dëshmive të palës përgjegjëse dhe tregoi se ai nuk dëshironte të bashkëpunonte me Sekretarinë Ekzekutive. Në këto rrethana kërkesa duhet të refuzohet.

D. Kërkesa të miratuara.

50. Në kërkesat nr. 51793, 51794 dhe 51798, të përmendura në pjesën C të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore për të njëjtat prona që kërkon paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 01449, 01450 dhe 01453 (shih paragrafin 34 sipër). Në kërkesat nr. 51793, 51794 dhe 51798, paraqitësi i kërkesës ka parashtruar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht e bija e mbajtësit të së drejtës pronësore, Ljubomir Dimic. Kërkesat nr. 01449, 01450 dhe 01453 janë dorëzuar nga nipi i Ljubomir Dimic, dhe në mungesë të autorizimit këto kërkesa duhet të hidhen poshtë; shih paragrafin 34 dhe 38 më sipër.

51. Paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 51793, 51794 dhe 51798 ka paraqitur fletën poseduese e cila tregon se babai i paraqitësit të kërkesës, Ljubomir Dimic, është mbajtësi i së drejtës pronësore të pronave të kërkuara. Më tej, paraqitësi i kërkesës paraqiti një vërtetim i cili konfirmon vdekjen e mbajtësit të së drejtës pronësore. Fleta poseduese dhe vërtetimi janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vlefshme. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur dhe verifikuar gjithashtu certifikatën për të drejtat pronësore të pronës së paluajtshme nr. 59 e cila e tregon babain e paraqitësit të kërkesës si mbajtësin e të drejtës pronësore.

52. Rrjedhimisht, pasi provat vërtetojnë se prona e kërkuar i takon Ljubomir Dimic, duhet të miratohet një vendim i cili të konfirmojë të drejtën pronësore në dobi të mbajtësit të së drejtës pronësore në kërkesat nr. 51793, 51794 dhe 51798.

E. Kërkesa për kompensim.

53. Në kërkesat e përmendura në kolonat përkatëse të pjesës C të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e

miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, ky aspekt i kërkesave duhet të hidhet poshtë.

F. Vërejtjet përmbledhëse.

54. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rast, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

55. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

56. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësve të kërkesave ose mbajtësve të së drejtës pronësore për të kërkuar informacion për të drejtën e tyre pronësore për pronat e kërkuara, para autoriteteve vendore kompetente të tilla si organet kadastrale ose gjykatat vendore, në pajtim me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA38043	KPA38044	KPA38045	KPA38046	KPA38047	KPA44015	KPA44021
KPA44026	KPA44031	KPA00437	KPA08235	KPA08239	KPA30841	KPA30842
KPA30843	KPA30844	KPA30845	KPA30846	KPA30847	KPA30848	KPA30849
KPA30850	KPA36541	KPA36542	KPA36543	KPA36544	KPA11649	KPA11653
KPA13634	KPA00732	KPA01449	KPA01450	KPA01453	KPA13629	KPA38708
KPA38710	KPA38711	KPA41160				

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA24201	KPA24204	KPA24214	KPA24216	KPA24220	KPA24222	KPA24225
KPA24227	KPA24228	KPA24229	KPA23497			

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA51793	KPA51794	KPA51798				
----------	----------	----------	--	--	--	--